



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/56  
Datë: 11.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 dhe 34 të Ligjit 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, Ligjin Nr. 07/L-041 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 janar 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet alokimi i parakohshëm nga ndarjet aktuale buxhetore të organizatës buxhetore Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me kod 320, në nën-programin Zgjedhjet me kod 14200, për të gjitha kategoritë e shpenzimeve me qëllim të organizimit dhe mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas kërkesës së datës 08 Janar 2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Aprovohet kërkesa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me kod 320, për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 165,850 euro, në nën programin Zgjedhjet me kod 14200 për këto kategori të shpenzimeve:
  - 2.1. Shuma prej 22,250 euro në kategorinë shpenzimeve komunale, dhe
  - 2.2. Shuma prej 143,600 euro në kategorinë e shpenzimeve kapitale dhe atë për këto projekte:
    - 2.2.1. Shuma prej 140,000 euro për projektin me kod 18716 - "Zhvillimi i softuerit të Qendrës së numërimit dhe rezultateve" (buxhetuar në vitin 2020), dhe
    - 2.2.2. Shuma prej 3,600 euro për projektin - "Makinë për pastrimin e dysHEMEVE" (projekt i ri).
3. Mjetet nga pika 2. e këtij vendimi, merren nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nën - programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve të rezervës.
4. Në përputhje me piken 1. të këtij vendimi, orët e punës shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për punonjësit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kalkulohen dhe paguhen sipas legjislacionit në fuqi, nga ndarjet aktuale buxhetore në kategorinë paga dhe shtesa.
5. Obligohet Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.


## A r s y e t i m

KQZ me Ligjin e Buxhetit ka të ndara në programin e zgjedhjeve shumën prej 8,051,575 euro, të cilat mund të përdoren për përmbushjen e këtij obligimi.

Kërkesa e KQZ e datës 08.01.2020, sipas këtij vendimi përmbushet përmes alokimeve të parakohshme të buxhetit tashmë të ndarë me Ligjin për Buxhetin e vitit 2021 në mallra dhe shërbime, si dhe ndarjes shtesë buxhetore në kategorinë e kapitaleve dhe shpenzimeve komunale.

Për pagesën e orëve të punës jashtë orarit, do të përdoret ndarja aktuale buxhetore, ndërsa kalkulimi dhe pagesa e tyre bëhet sipas legjislacionit në fuqi, deri në kufirin e lejuar për punë jashtë orarit.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

### Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë